



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:125553
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05479966

C.nr.1304/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve, A.F. dhe Z.F. që të dy nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. M.Q. nga Prizreni, kundër të paditurit Sh.B. nga fsh. Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson B.P. nga Prizreni, për shkak të pengim posedimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me dt. 05.03.2024, në prezencë të të autorizuarës së paditësve dhe të autorizuarit të paditurit, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësve A.F. dhe Z.F. që të dy nga fshati Komuna e Prizrenit, me të cilën kanë kërkuar që të “Vërtetohet se i padituri Sh.B. i ka penguar në shfrytëzim të qetë dhe të lirë në pushtetin e tyre faktik të fundit paditësit A.F. dhe Z.F. ashtu që me dt. 27.07.2017 duke i prerë trupat e kumbullave ka bërë pengim posedimin në paluajtshmërinë nr. 367-2 ZK Llokvicë si dhe të Urdhërohet i padituri që në të ardhmen të mos i pengoj paditësve në pushtetin e tyre faktik”.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësit A.F. dhe Z.F. përmes të autorizuarës së tyre av. M.Ç. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 18.08.2017, kanë paraqitur padi kundër të paditurit Sh.B. për shkak të pengim posedimit, e evidentuar me numër C.nr. 1022/2017.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka vendosur përmes Aktvendimit numër C.nr. 1022/2017 të dt. 07.08.2019, me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësve, mirëpo pas paraqitjes së ankesës, gjykata e shkallës së dytë me Aktvendimin numër Ac.nr. 1091/2020 të dt. 13.07.2020 lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje në këtë gjykatë dhe lënda ka marrë numrin C.nr. 1304/2020.

Paditësit përmes të autorizuarës së tyre me parashtresën e dt. 25.10.2017, në kuptim të nenit 257 të LPK-së, kanë bërë ndryshimin e bazës juridike dhe kanë zgjeruar padinë edhe me

paditës të tjerë, ashtu që nga kërkesa për pengim posedim kanë kërkuar vërtetimin e pronësisë, mirëpo në seancën e dt. 15.09.2023, e autorizuar e paditësve është tërhequr nga kjo kërkesë.

Paditësit përmes të autorizuarës së tyre në seancën e dt.12.01.2024 kanë kërkuar që për shkak të ekonomizimit të procedurës të bëhet bashkimi i padive, ashtu që kësaj lënde me objekt kontesti pengim i posedimit ti bashkohet lënda e evidentuar pranë kësaj gjykate C.nr. 4694/2023 me bazë juridike vërtetim i pronësisë, mirëpo kjo gjykatë përmes aktvendimit në seancën e dt.13.02.2024 e ka refuzuar një kërkesë të tillë.

Në padi kanë theksuar se paditësit janë shfrytëzues dhe posedues të qetë dhe të lirë në pushtetin e fundit faktik të paluajtshmërisë, të cilën e ka blerë babi i tyre, që nga viti 2005 në bazë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr.4372/2005 të datës 25.08.2005. Me ç ‘rast nga ky fakt, në paluajtshmërinë -ngastra kadastrale nr.367/3 në vendin e quajtur “Lasce Greven” kulturë livadh e klasit të 6-të ZK Lokvicë, në sipërfaqe prej 1 ari 29m2, paditësit kanë punuar e mbjellë kumbulla, kështu e kanë shfrytëzuar pa u penguar nga askush edhe nga këtu i padituri deri me datën 27.07.2017, kur i padituri ka ndërhyrë me punime në parcelën në fjalë pasi i ka prerë trupat e kumbullave, i ka penguar paditësit në shfrytëzimin e lirë

të tyre sepse kanë qenë në pritje të pjekjes së frutave të tyre. Nga veprimet e të paditurit nga data 27.07.2017 paditësit janë penguar tej mase në shfrytëzimin e qetë dhe të lirë në pushtetin faktik të fundit të paluajtshmërisë për çka i janë drejtuar Drejtorisë së Inspektorateve e cila e ka konstatuar gjendjen në terren dhe ka përpiluar procesverbal. Andaj i ka propozuar gjykatës që të vërtetohet se i padituri i ka penguar paditësit në shfrytëzimin e qetë dhe të lirë faktik.

Gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditësve ka deklaruar se momenti i pengimit është evident në procesverbalin e dt. 08.08.2017 lëshuar nga Drejtoria e Inspektorateve, kur i padituri ka filluar ti prej frutat e kumbullat me qëllim që t’ia mbyll dyert e hyrjes këtu paditësve. Po ashtu ka theksuar se me pranimin e ekspertizës së gjeodezisë, nëse rastin konkret e shohim në këndvështrim të pengim posedimit në drejtim të padisë së paraqitur në vitin 2017 me vet faktin e parashtrimit të kësaj padie, janë ndalur veprimet e të paditurit me çka sipas paditësve i padituri është vetëdijësuar se ka bërë pengim posedim, pra vet parashtrimi i padisë e ka arritur qëllimin vetëm ka mbetur ti ndalohej të paditurit që në të ardhmen të mos ndërmer asnjë veprim në objektin të cilin kanë paraqitur padi për vërtetim të pronësisë. Pas pranimit të ekspertizës së gjeodezisë ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri ka kryer pengim posedimin me dt. 27.07.2017, duke i prerë trupat e kumbullave në paluajtshmërinë 367-2 ZK Lokvicë si dhe ka kërkuar që të urdhërohet që i njëjti edhe në të ardhmen të mos i pengoj paditësit në pushtetin e tyre faktik. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 1820 euro.

Gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurit ka deklaruar se klienti i tij asnjëherë nuk i ka penguar paditësit, duke theksuar se është bërë një gabim që është ftuar në cilësinë e të paditurit, ngase është e vërtetë që paditësi është komshinj me paditësit por që paluajtshmërinë e tij e kishte blerë në vitin 2016 dhe ka marrë numër P-71813045-00367-2 me sip.369 m2, e cila nuk ka të bëjë fare me ngastrën për të cilën është para gjykatës, ngase sipas padisë për pengim posedim shihet se pengim posedimi është bërë në ngastrën 367/3 në vendin e quajtur në vendin e quajtur “Lastce Greben”, ZK Lokvicë, me sip.1 ha, 29 m2. Për këtë i padituri asnjëherë nuk e ka penguar apo të ketë marrë ndonjë veprim të kundërligjshëm apo të ligjshëm ndaj paditësve. Me çka gjykatës i ka dorëzuar certifikatën 07-029-7649-23-Ç, në të cilën janë të përfshirë pronat e paluajtshme në emrin e të paditurit e njëra ndër to është edhe ngastra e cila është afër me ngastrat e paditësve 00367-2 me sip. 369 m2. Ka

shtuar se i padituri ka shkuar të pastroj ngastrën nga shkurret, mirëpo paditësit ia kanë larguar punëtorët, duke ritheksuar se objekt i kësaj çështje nuk ka të bëjë me parcelën e të paditurit pasi që parcela e paditësve është po ashtu me numër 7181-3045-00367/3 me sip. 129 m², ku i padituri nuk është pronar i kësaj parcele. Në fotot e padisë shihet se vet pronari i kësaj ngastre është penguar të pastroj dhe prej drunjte nga Inspektorati dhe Policia. Përfundimisht ka theksuar se për të paditurin është e paqartë se çfarë kërkojnë paditësit pasi që herë kërkojnë pengim posedim herë kërkojnë vërtetimin e pronësisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar në bazë të tarifës së OAK-së.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Kopjen e kontratës në gjuhën boshnjake, me nr. Leg.4372/2005, e dt.22.08.2005, e lidhur ndërmjet M.M. dhe R.F. Kopjen e procesverbalit me nr.0004695 e dt.08.08.2017, lëshuar nga Drejtoria e Inspektorateve, 1 Fotografi, certifikata e pronësisë me numër 07-029-7649-23-Ç, e dt.14.09.2023, kontrata me nr.LRP.nr.3044/16, me nr. të ref.747/2016, Certifikata e pronësisë e personit E.M. me nr.07-029-23226, e dt.08.06.2016, kopja e planit për njësinë P-7181-3045-00367-2, me sip.369m² lëshuar nga Agjencia Kadastrale me dt.31.10.2023 dhe harta e gjeoportalit si dhe ekspertiza e gjeodezisë të datës 04.12.2023 punuar nga eksperti gjyqësor i gjeodezisë D.B. dëgjimi i dëshmitarit O.M. dëgjimi i dëshmitarit E.M.

Nga leximi i kopjes së kontratës në gjuhën boshnjake, me nr. Leg.4372/2005, e dt.22.08.2005, e lidhur ndërmjet M.M. dhe R.F. gjykata ka gjetur se shitësi M.M. dhe blerësi R.F. kanë lidhur kontratë të shitblerjes për parcelën 367/3 në vendin e quajtur “Lasce Greben” me kulturë livadh, klasa e gjashtë në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.29 ari e regjistruar në listën poseduese nr. 273 (e re) KK Lokvicë.

Nga leximi i kopjes së procesverbalit me nr.0004695 e dt.08.08.2017, lëshuar nga Drejtoria e Inspektorateve, gjykata ka vërtetuar se inspektorët në bazë të kërkesës nr.17-321-104991 kanë kryer inspektim lidhur me kryerjen e punëve – prerjen e trupave të kumbullave në parcelën nr.367/3 në vendin e quajtur “Lasce Greben” me kulturë livadh, klasa e gjashtë në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.29 ari, me ç’rast kanë lëshuar urdhër të inspektorit që palët të mos ngatërrohen në mes vete.. shiriti sigurues për ndalim punimesh të mos preket -hiqet.

Nga Fotografia e pa datuar, gjykata gjeti se në parcelën kontestuese ku është bërë pengimi vërehen shiritat sigurues, vërehet gjendja e parcelës, prerja e drunjteve dhe pozicioni i tyre.

Nga leximi i certifikatës së pronësisë me numër 07-029-7649-23-Ç, e dt.14.09.2023, gjykata ka vërtetuar se njësia kadastrale P-71813045-00367-2, në sipërfaqe prej 369 m², në vendin e quajtur Lasce Greben, me tokë pyjore, mal i klasës së 5 / bujqësore livadh i klasës së 6, evidentohet në emër të Sh.B. me 1/1 e pronës.

Nga leximi i kontratës me nr.LRP.nr.3044/16, me nr. të ref.747/2016, gjykata ka gjetur se palët E.M. Shitës dhe Sh.B. – blerës kanë lidhur kontratë për shitblerjen e paluajtshmërive për 11 njësi kadastrale, ku pjesë e tyre është edhe ngastra kadastrale kontestuese P-71813045-00367-2 me sipërfaqe të përgjithshme 369m², me kulturë livadh i klasës 6 dhe mal i klasës, vendi i quajtur “Lasce-Greben”.

Nga leximi i certifikatës së pronësisë e personit E.M. me nr.07-029-23226, e dt.08.06.2016, gjykata ka gjetur se njësia kadastrale P-71813045-00367-2, në sipërfaqe prej 369 m², në

vendin e quajtur Lasce Greben, me tokë pyjore, mal i klasës së 5 / bujqësore livadh i klasës së 6, me datë 08.06.2016 ka qenë e evidentuar në emër të E.M. me 1/1 e pronës.

Nga leximi i kopjes së planit për njësinë P-7181-3045-00367-2, me sip.369m² lëshuar nga Agjencia Kadastrale me dt.31.10.2023, gjykata ka parë pozitën e kësaj ngastrë dhe numrin e ngastrave kadastrale me të cilat rrethohet ngastra kadastrale kontestuese.

Nga leximi i hartë e gjeoportalit gjykata ka vërejtur gjendjen ekzistuese të ngastrës kadastrale 397-1.

Gjykata me dt. 24.10.2023 së bashku me ekspertin gjeodet D.B. ka dalë në vend shiqim me ç'rast ka konstatuar se ngastra kadastrale nr. 00367-2 ZK Lokvicë, ka sipërfaqe jo të rrafshët dhe ka qenë e mbuluar me pemë, drunjë të shumtë të cilët kanë një gjatësi që shihet se kanë qenë të rritur tani e një kohë, nga ana perëndimore e ngastrës gjendet një mur prej betoni masiv mbi të cilin ishin të vendosura disa rrethoja prej metalit në formë dekori, ndërsa nga ana lindore ngastra kufizohet me disa shtylla prej betoni në distancë 1m e gjysmë larg nga njëra tjetra e të cilat ishin të lidhura edhe me mjete metalike, nga ana lindore kjo parcelë ishte e kufizuar me rrugën publike e cila ishte e kubëzuar.

Nga Ekspertiza e punuar nga eksperti i gjeodezisë me datë 04.12.2023 gjykata gjeti se njësia kadastrale nr. 00367-2 ZK Lokvicë është e lirë nga ndërtime, nga anët veriore, lindore dhe perëndimore është e rrethuar pjesërisht me shtylla të betonit dhe rrethoj metalike, ndërsa nga ana jugore kufizohet me rrugën publike dhe nuk ka ndonjë rrethoj. Po ashtu nga ana jugore e saj vërehen disa drunj të rritur në mënyrë natyrale të cilat nuk janë të mirëmbajtura. Sipas identifikimit në terren parcela fqinje nr.00365-0 ka hyrje daljen faktike për në rrugën publike të orientuar nga ana perëndimore në të cilën gjendet dera metalike e mbështetur në dy shtylla betoni – saktësisht hyrje – dalja e parcelës fqinje nr. 00365-0 kufizohet me kufirin jug-lindor të parcelës nr.00367-2. Lokacioni ku gjendet parcela, objekt i këtij kontesti, ka konfiguracion të pjerrtë – saktësisht ka ndryshim të disnivelit nga ana jugore (poshtë) në drejtim të anës veriore (lartë). Po ashtu është theksuar se parcela me numër 00367-2 ZK Lokvicë kufizohet: nga ana veriore me parcelën nr. 00364-0, nga ana lindore me parcelën nr. 00365-0 nga ana jugore me parcelën numër 2951-0 dhe nga ana perëndimore me par. 00367-1 dhe 00366-0.

Nga dëgjimi i dëshmitarit O.M. gjykata ka gjetur se: “Rasti i palëve është një problem prej shumë më herët, ka theksuar se e njeh shumë mirë G.B. të atin e Sh. (të paditurin), po ashtu ia njeh edhe vëllain S. Ky problem ka lindur për shkak të ngastrave të ndara të cilat nuk janë regjistruar në regjistrat e kadastrit. Përpara se ti prente pemët me punëtorët e tij, ai iu kishte thënë të mos i prekin se këto janë të familjes sime dhe të fqinjit A.F. dhe ia kishte treguar dokumentacionin dhe policisë njëkohësisht - fletë posedimin në emër të babait të A. R.F. dhe një fletë posedim në emër të M.M. i ati i E.M. si dhe Aktvendimin për vërtetimin e taksës Komunale për qarkullimin e paluajtshmërisë në emër të R.F. si dhe kontratën e lidhur në mes shitësit M.M. dhe blerësit R.F. e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prizrenit. Me ç'rast punëtorëve dhe i kishte thënë mos i preni këto kumbulla sepse kanë kontest dhe mos i prekni derisa të vjen Avdo sepse gjendet në Prizren, në atë kohë kishte ardhur edhe policia e cila e kishte ndaluar punën, ditën e nesërme kishte ardhur edhe Inspeksioni dhe i patën ndërpreur punimet në tërësi. Pas kësaj ka shkuar te A. në oborr të shtëpisë së tij dhe kishte thënë nëse me të vërtetë e ke blerë këtë pronë atëherë nuk do të përzihem. Tutje ka shtuar se E.M. i kishte shitur 11 ngastra në tërësi e njëra ndër to edhe parcelën e pjerrtë të cilën babai i E. ia kishte shitur atë parcelë ka shfrytëzuar R. dhe familja e tij për të hyrë në shtëpinë e tij. Pas vitit 2017 kjo parcelë nuk është prekur, por më herët e kanë shfrytëzuar

familja jonë- A., Z., N., A. dhe F. të cilët tash e 50 vite jetojnë në Francë, ashtu që e kanë hapur rrugën, e kanë rrethuar me shtylla betoni dhe e kanë mirëmbajtur. Para vitit 2017 të mirat e pemëve i kanë marrë personat që jetojnë në Francë, ndërsa për to janë kujdesur fqinjët, kushërinjtë, kush ka mundur, ndërsa edhe ata shpesh kanë ardhur nga Franca pasi që i kanë sjellë fëmijët dhe kanë dëshirë të vijnë këtu.”

Nga dëgjimi i dëshmitarit E.M. gjykata ka gjetur se: “Lidhur me këtë parcelë E.M. ia pat shitur një ngastër e cila gjendet afër shtëpisë së tij dhe atëherë i kishte thënë bleje edhe këtë parcelë që është kontestuese, me këtë çmim të kësaj parcelës që ka tentuar të iashes, të cilën ai deklaroi se nuk e kishte blerë sepse atë ngastër i ati i E., M.M. ia kishte shitur R.-të atit të A.. Atëherë ai kishte filluar të ndërtoj shtëpinë dhe si duket nuk ka pasur rrugë dhe atëherë e ka blerë nga M.M. ngastrën të cilën nuk e din saktësisht se cila është, mirëpo ne kështu e dimë sepse nuk ka mundur të hyj në shtëpi. Ndërsa viti 1980 i shënuar tek dyert e A. ka deklaruar se ndoshta tregon datën kur para luftës është blerë për të hyrë në shtëpi. Duke shtuar se jeton afër 50 m, larg shtëpisë së R. dhe pjesa e rrugës para këtyre dyerve është shfrytëzuar nga paditësit, ngase është rruga që i shpie në shtëpi të tyre dhe askush tjetër përpos A. dhe familjes së tij nuk e ka shfrytëzuar. Tutje ka shtuar se nuk i kujtohet kush e ka shfrytëzuar parcelën afër dyerve të familjes F. me gjasë nga askush sepse aty janë rritur shkurret dhe therrat, përveç shkurreve dhe therrave nuk ka pasur asgjë, ka qenë arë, askush nuk ishte kujdesur për atë, ndërsa në vitin 2017 ka deklaruar se nuk e din nëse dikush ka qenë duke e mirëmbajtur këtë parcelë”.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar.

Ligji Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore (në vijim: LPSD), ndër të tjera e rregullon edhe çështjen posedimit. Neni 103 i këtij ligji ka paraparë së “*Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*”. Tutje neni 104 i LPSD-së përcakton së “*Posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes*”. Në nenin 110 të LPSD-së theksohet së “*Personi i cili e posedon një send që është pronë e tij, është posedues pronësor*”. Ndërsa në nenin 107 par. 1 të LPSD-së është paraparë së “*Posedimi shuhet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humb pushtetin faktik*”. Neni 113 par.1, 2 dhe 3 i LPSD-së ka paraparë së “*Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore. Kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit*”. Ndërsa në nenin 480 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore është paraparë së “*Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përjashtohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit*

të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit”.

Gjykata fillimisht ka vlerësuar afatshmërinë e padisë dhe ka vërtetuar se paditësit kanë marrë në dijeni lidhur me privimin nga posedimi me datën 27.07.2017, datë kjo kur të njëjtit kanë vërejtur se i padituri ka filluar prerjen e pemëve-kumbullave, ndërsa padinë në gjykatë e kanë paraqitur me datë 18.08.2017, andaj nga kjo rezulton se padia është parashtruar brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, afat ky i paraparë me nenin 114 të LPDTS-së.

Gjykata në mbështetje të dispozitave të sipërcituara dhe në bazë të nenit 480 të LPK-së, është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit.

Pas vlerësimit të provave të administruara, gjykata gjeti së kërkesëpadia paditësve është e pabazuar, kjo ngase fillimisht në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë kontestues fakti se i padituri me dt. 27.07.2017 kishte filluar prerjen e drunjëve në ngastrën nr. 367/3 në vendin e quajtur “Lasce Greben” me sipërfaqe 1 ari e 29 m2, fakt i cili vërtetohet nga Procesverbali i lëshuar nga Drejtoria e Inspektorateve nr. 004695 i dt. 08.08.2017, në të cilin është shënuar se *“i padituri kishte filluar prerjen e kumbullave dhe i kishte paluar rreth rrugës”*, në këtë drejtim, gjykata gjeti se veprimet e të paditurit Sh.B. lidhur me prerjen e drunjëve janë pranuar edhe nga i padituri dhe janë kryer në parcelën numër 367/2 në sip. të tërësishme prej 369/m2, ngastër kjo e identifikuar nëpërmes ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë D.B. e punuar me dt. 08.11.2023.

Mirëpo gjykata vë në dukje se për rastin konkret për të ekzistuar akti i pengim posedimit duhet në mënyrë kumulative të përmbushen dy kushte ligjore dhe atë duhet që paditësit të kenë posedimin e fundit faktik, respektivisht të jenë posedues dhe kushti tjetër është që personi i caktuar i cili në mënyrë të kundërligjshme e ka kryer aktin e pengim posedimit, me ç’rast nga të gjithë provat e administruara në këtë kontest, rezulton se nuk janë përmbushur këto dy kushte kumulative, e në veçanti fare nuk bëhet fjalë për kushtin e parë të posedimit të fundit faktik.

Në rastin konkret për gjykatën nuk u vërtetua fakti se paditësit kanë pasur posedimin e fundit faktik të parcelës me numër 367/2 në sip. të tërësishme prej 369/m2 ZK Lokvicë, apo më saktësisht pjesën ku pretendohet ku është kryer akti i pengim posedimit, një fakt të tillë fillimisht gjykata e vërtetoi nga deklarimi i dëshmitarit E.M. i cili ka deklaruar se jeton vetëm 50 m larg kësaj parcele dhe se ka deklaruar se në parcelën me numër 367/2 në sip. të tërësishme prej 369/m2 ZK Lokvicë në vitin 2017 *“përveç shkurreve nuk ka pasur asgjë, ka qenë arë dhe askush nuk është kujdesur për të”*. Gjithashtu nga deklarimi i dëshmitarit O.M. gjykatës i rezultoi i vërtetuar fakti se paditësit kanë pasur në shfrytëzim pjesën e rrugës që shpie në parcelën ku jetojnë paditësit, i cili në pyetjen e gjykatës se kush e ka shfrytëzuar në vitin 2017 parcelën me numër 00367/2 me sip.369m2, është deklaruar *se e ka shfrytëzuar R. dhe familja e tij për të hyrë në shtëpinë e tij*, në rastin konkret pengimi i pretenduar nuk është bërë në rrugën që shfrytëzojnë paditësit për të hyrë në shtëpinë e tyre por është bërë me aktin e prerjes së drunjëve-pemëve dhe shkurreve që kanë qenë në kufirin e ngastrës 00367/2 me sip.369m2 dhe ngjitur me rrugën që të shpie tek dera e hyrjes e paditësve.

Gjykata nuk i pranoi deklarimet e paditësve në padi, por edhe deklarimin e dëshmitarit O.M. se paditësit para datës 27.07.2017 e kanë mirëmbajtur këtë parcele dhe se i kanë shfrytëzuar të

mirat e frutave prej këtyre pemëve të prera nga i padituri, ngase nga e vetmja provë materiale të cilën e kanë propozuar paditësit në lidhje me gjendjen faktike pas aktit të pengim posedimit - dhe atë një fotografi e pa datuar në të cilën vërehet intervenimi i Drejtorisë së Inspektorateve me shirit sigurues, gjykata vërejti se kjo parcelë nuk ka qenë aspak e mirëmbajtur, në të nuk është punuar dhe aty kanë qenë të rritura shkurre dhe një pemë për të cilën me asnjë provë nuk u vërtetua se çfarë lloji ka qenë.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë jo relevante për këtë çështje kontestimore me objekt të kontestit pengim i posedimit, të njëjtat kanë pasur për qëllim të vërtetojnë të drejtën e pronësisë, andaj në këtë kuptim gjykata nuk iu referua në mënyrë të veçantë dhe vlerësoi se janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit këtij aktvendimi, bazuar në nenit 449 par.2 dhe nenit 450 të LPK-së, për shkak se paditësit e kanë humbur kontestin, ndërsa të paditurin gjatë procedurës e ka përfaqësuar personi që nuk është avokat dhe të njëjtit nuk mund ti njihen shpenzimet e procedurës për punën e avokatit sikurse i ka kërkuar sipas tarifës së OAK-së. Ndërsa me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do ti shpërblehen palës së paditur, gjykatës nuk iu janë ofruar ndonjë provë nga i padituri me të cilat do të vërtetohej se i janë shkaktuar shpenzime për këtë çështje, që do të mund ti njiheshin sipas nenit 453 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS) dhe nenin 142.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1304/2020 më datë 20.03.2024

Gjyqtare

Diora Bajrami

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.